




REPUBLIKA E KOSOVËS
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës
Opština Mitrovica – Municipality of Mitrovica

DREJTORIA PËR SHËNDETËSI



Plani i Punës

2023

Mitrovicë

Janar 2023

Dreitoria e Shëndetësisë

Drejtoria për Shëndetësi kryen keto detyra dhe është përgjegjëse për:

1. Sigurimin dhe zbatimin e kujdesin parësor shëndetësor publik dhe për vlerësimin e gjendjes shëndetësore të qytetarëve, obligohet të zbatohet me prioritet masat prioritare të promovimit dhe parandalimit në kujdesin shëndetësor;
2. Harton strategjite për kujdesin parësor shëndetësor, bazuar në nevojat e identifikuar në nivel lokal duke u dhënë prioritet masave parandaluese, në respektim të gjendjes shëndetësore, moshës, gjinise, pozitës ekonomiko-sociale të qytetarëve, kushteve dhe mundësive në ofrimin e kujdesit shëndetësor, kushteve teknologjike, mjekësore, distances, konfiguracionit geografik, dhe perbërjes së institucioneve të kujdesit parësor shëndetësor të Komunes së Mitrovicës së Jugut;
3. Harton Planin operativ të zhvillimit të kujdesit parësor shëndetësor, plani i procedohet Kuvendit të Komunes për miratim paraprak dhe e miraton Ministria në propozim të Kuvendit të Komunes, në patim me planin afat-mesëm të miratuar nga Qeveria;
4. Organizon dhe zbaton mbikëqyrjen profesionale, juridike dhe financiare të shëndetësisë primare;
5. Vlerëson nevojat dhe përcakton prioritetet lokale dhe objektivat në baze të informatave, në përputhje me strategjinë e kujdesit parësor shëndetësor;
6. Planifikon, harton dhe menaxhon buxhetin e kujdesit primar shëndetësor, në përputhje me nevojat lokale dhe dispozitat ligjore në fuqi;
7. Vlerëson nevojat lokale për shëndetësinë primare;
8. Zbaton dispozitat ligjore dhe Rregulloren komunale në fushën e shëndetësisë primare;
9. Mbikëqyr situatën epidemiologjike në nivel të Komunes;
10. Kujdesin shëndetësor mendor të bazuar në bashkësi;
11. Mbikëqyr dhe koordinon Qendren Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF);
12. Monitoron dhe kërkon raportime periodike dhe vjetore nga QKMF;
13. Ndërmerr fushata sensibilizuese me faktor tjerë dhe organizata në drejtim të preventives dhe ruajtjes së shëndetit për qytetarët e Komunes;
14. Edukimi dhe promovimi shëndetësor i popullatës, me prioritet grupet e rrezikut;
15. Mbledhje dhe analizon informatat në fushën shëndetësore në nivel lokal;
16. Raporton lidhur me ofrimin e shërbimeve shëndetësore dhe të arriturave komunale në këto fushë;
17. Zbaton vendimet e Kryetarit dhe vendimet e Kuvendit Komunal;

18. Ushtron kompetenca te tjera dhe pergjegjesi duke zbatuar dispozitat ligjore, Statutin e Komunes, dhe aktet tjera nenligjore te Institucioneve te nivelit gendror;

19. Me qellim te rritjes se cilësisë se shërbimeve shëndetësore, institucionet ne nivel parësor te kujdesit shëndetësor do te sigurojne bashkepunimin ndersektoral me shërbimet e mirëqenies sociale, me shërbimet edukativo arsimore dhe organet e sigurise publike, me organizatat e veçanta profesionale, si dhe me organizatat humanitare, qeveritare e joqeveritare;

Bazuar në pikat e lartë cekura ka hartuar edhe planin e punës se Drejtorisë për vitin 2023

Nr	Plani Strategjik Qëllimet/Objektivat Aktivitetet	Gjasat dhe rreziqet	Përgjegjësit	Afati kohor	Buxheti
1.	Përgatitja e raportit të punës për vitin 2022	Gjasat reale për ta përpiluar	DSH	01-15 Janar 2023	-
2.	Krijimi dhe sigurimi i një politike kyçe të mbikëqyrjes dhe të monitorimit mbi punën dhe aktivitetet e QKMF-së, me qëllim të zbatimit të ligjit të shëndetësisë, akteve nënligjore dhe strategjisë sektoriale.	Gjasat reale për ta zbatuar	DSH	Janar - Dhjetor - 2023	-
3.	Krijimi dhe zhvillimi i marrëdhënieve të mira me donatorët, OJQ-të e ndryshme dhe me partnerët tjerë të interesuar për të ndihmuar zhvillimin dhe avancimin e shërbimeve shëndetësore.	Gjasat reale për ti zbatuar projektet të ndryshme në partneritet	DSH & OJQ-të & DONATORT	Janar - Dhjetor - 2023	
4.	Ndihma momentale me mjete financiare personave qe vuajnë nga sëmundjet e ndryshme	Gjasat reale për ta zbatuar	DSH	Janar - Dhjetor - 2023	130,000.00
5.	Hartoni akte normative si dhe aktet tjera juridike të cilat dalin nga fushë veprimtarie e drejtorisë në bazë të procedurave të përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi	Gjasat reale për ta zbatuar	DSH	Janar - Dhjetor - 2023	
6.	Hartimi i paramasave dhe parallogarive për investimet kapitale dhe realizimi tyre	Gjasat reale për ta zbatuar	DSH DPU NJP	Mars - Nëntor - 2023	3,000.00
7.	Bashkëpunon dhe komunikon me njësi të tjera Brenda dhe jashtë institucionit për aktivitetet që ndërlidhen me fushën e legjislacionit;	Gjasat reale për ta zbatuar	DSH	Janar - Nëntor - 2023	
8.	Planifikimi i buxhetit për DSh	Planifikimi buxhetor bëhet në bashkëpunim me DSh, QKMF	DSH QKMF DBF	15 maj -31 shtator 2023	-
9.	Vizitat të rregullta në QKMF, QMF, AMF, qëllimi i së cilave ka për rrjedhojë vënien në pah të dukurive dhe zhvillimeve që karakterizojnë natyrën e punës.	Ky proces do të realizohet sipas orarit të vizitave të rregullta nëpër pikat shëndetësore.	DSH QKMF QMF AMF	Gjatë tërë vitit	-

10.	Bashkëpunim permanent me grupin e trajnerëve për edukim të vazhdueshëm infermieror.	Programin ekzistues vazhdon, sipas nevojës do të inkorporohen dhe module tjera si p sh: moduli mbi edukimin seksual te adoleshentë.	DSH QKMF	Janar - Dhjetor - 2023	-
11.	Bashkëpunimi me grupin e trajnuesve të QKMF-së në organizimin e ligjeratave nëpër shkollat e mesme me qëllim të sensibilizimi të adoleshenteve mbi edukatën seksuale, hiv aids, higjena orale, perdorimi i dorgave, etj.	Keto ligjërata do të mbahet nëpër te gjitha shkollat dhe do të realizohet në bashkëpunim me Drejtorinë e Arsimit.	DSH QKMF DKA	Janar - Dhjetor 2023	-
12.	Bashkëpunimi i vazhdueshëm me stafin menaxhues – Kryeinfermierin e QKMF-së.	Takime të rregullta me kryeinfermierët me qëllim të zbatimit të strategjisë politike në Kujdesit Parësor Shëndetësor si dhe evidentimin e problemeve që mund të na kanosen.	DSH QKMF	Janar - Dhjetor - 2023	-
13.	Takimet e rregullta me menaxhmentin e QKMF-se, dhe shefat e sektorëve.	Marrja e vendimeve për çështje të ndryshimeve si dhe përcjellja e zbatimit të tyre.	DSH QKMF	Gjatë vitit 2023	-
14.	Kthimi i përgjigjeve dhe futja në sistemin e Intranetit i te gjitha kerkesave drejtuar DSh-së	Gjasat reale për ta zbatuar	DSH	Janar - Dhjetor - 2023	-
15.	Konsultimi me palët që kanë takim me drejtorin dhe e njoftoj atë paraprakisht.	Shpjegimi i procedurave administrative për palët që kanë të bëjnë me kërkesat, ankesat sugjerimet ndaj DSH-së.	DSH	Gjatë tërë vitit	-
16.	Vizitat sistematike per nxenesit e Shkollave te Komunes së Mitrovices	Gjasat reale për ta zbatuar	DSH QKMF	Janar – Dhjetor	-
17.	Hartimi i planit te punës për vitin 2024	Gjasat reale për ta përpiluar	DSH	Dhjetor 2023	-

Drejtori
Fahri Shabani

